

VENDIM
Nr.1161, datë 25.11.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I NIVELI TË PARË”, NË
UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS, DHE PËR MIRATIMIN E
KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME
STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në fakultetin e ekonomisë dhe administrimit të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në:

a) “Menaxhim”, me profilet:

i) “Menaxhim biznesi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në menaxhim”, me profil menaxhim biznesi;

ii) “Marketing”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në menaxhim”, me profil marketing.

b) “Politika dhe administrim”, me profilet:

i) “Administrim publik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në politika dhe administrim”, me profil administrim publik;

ii) “Administrim financiar”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në politika dhe administrim”, me profil administrim financiar;

iii) “Drejtim turizmi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në Politika dhe administrim”, me profil drejtim turizmi.

c) “Ekonomi-biznes”, me profilet:

i) “Drejtim i SME-ve”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në Ekonomi - biznes”, me profil drejtim i SME-ve;

ii) “Financë - Bankë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në ekonomi - biznes”, me drejtim financë-bankë.

2. Programet e studimit “Master i nivelit të parë” realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore, në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuota e pranimeve në këto programe studimi “Master i nivelit të parë”, në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

- | | |
|-----------------------------|-----------|
| a) Menaxhim | 30 kuota; |
| b) Politika dhe administrim | 30 kuota; |
| c) Ekonomi-biznes | 30 kuota. |

5. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë në këto programe studimi, në vitin akademik 2009-2010, të jetë 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

6. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha